

Në bazë të nenit 20 dhe nenit 39 të Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/14, 98/15, 6/16, 198/18, 248/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.235/22), të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit të brendshëm, formën, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancim, mënyrën e realizimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës për të cilat është publikuar konkursi i brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 275/20), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-3334/2 të datës 24.02.2023

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
publikon
KONKURS TË BRENDSHËM NUMËR 1/2023
Për avancimin në karrierë të 2 nëpunësve gjyqësorë

1. Kategoria B, niveli B – 4
Udhëheqës i Sektorit të veprave penale

- 1 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura të paktën 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fakultetin juridik dhe provim të dhënë të jurisprudencës.

Së paku 4 vjet përvojë pune në profesion pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në Aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në orën 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premten

Neto rroga: 41.749,00 denarë

2. Kategoria B, niveli B – 4
Udhëheqës i Njesisë për resurse njerëzore

- 1 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura të paktën 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fakultetin juridik dhe provim të dhënë të jurisprudencës.

Së paku 4 vjet përvojë pune në profesion pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në Aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në orën 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premten

Neto rroga: 37.941,00 denarë

Në fletëparaqitjen, kandidatët do të bashkëngjisin dëshmitë për plotësimin e kushteve të posaçme dhe dëshmi për plotësimin e kompetencave të posaçme për vendin e punës edhe atë:

- Certifikatë për arsimin e kryer përkatës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter
- Dëshmi për përvojë pune
- Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohjen e një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter dhe
- Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter

Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t' i përmbushin në momentin e paraqitjes

Kandidatët detyrohen që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë të prerë dhe me të dhëna të sakta.

Fletëparaqitjen e plotësuar në formë të shkruar dhe dëshmitë për të dhënat që përfshihen në fletëparaqitjen, kandidatët detyrohen që përmes sportelit pranues ta dorëzojnë në Komisionin e seleksionimit për avancim.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 5 ditë, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në ueb faqen e Gjykatës.

Paralajmërim: Kandidati i cili do të parashtrijë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

Procedura për seleksionim dhe avancim do të realizohet sipas Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit të brendshëm, formën, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancim, mënyrën e zbatimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës për të cilat është publikuar konkursi i brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/20).